



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

**KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE “OPERATORI I PRODHIMIT TË UJIT”
SH.A. DHE PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN, PERIUdhËN
TRANZITORE DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË SË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator për furnizimin me ujë dhe largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e shoqërisë aksionare me emërtimin “*Operatori i Prodhimit të Ujit*” sh.a. (në vijim “*OPU sh.a.*”), si person juridik me kapital 100% shtetëror, me qëllim organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të ujit të pijshëm në nivel kombëtar.
2. Aksionari i vetëm i shoqërisë është Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila ushtron të drejtat e aksionarit në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe aktet nënligjore përkatëse.
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi, këtë vendim dhe statutin e saj, i cili miratohet sipas procedurave përkatëse.
4. OPU sh.a. krijohet si një strukturë e re organizative, e cila, në momentin e themelimit, nuk disponon asete, kontrata apo burime njerëzore operative, dhe e cila pajiset gradualisht me këto elemente nëpërmjet proceseve të parashikuara në këtë vendim.
5. Qëllimi i krijimit të OPU sh.a. është konsolidimi në një strukturë të vetme i aktivitetit të prodhimit, trajtimit, transmetimit të ujit për konsum publik në përputhje me legjislacionin në fuqi për sektorin e furnizimit me ujë, me synim rritjen e eficiencës operacionale, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë për operatorët e shpërndarjes.

6. Për realizimin e qëllimit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në mënyrë të fazuar, duke përfshirë fillimisht krijimin e kapaciteteve të nevojshme institucionale dhe, në vijim, ushtrimin e plotë të aktivitetit të saj tregtar.
7. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin:
 - a) organizimin dhe konsolidimin institucional dhe teknik të sistemeve të prodhimit të ujit për konsum publik;
 - b) përgatitjen për marrjen në administrim të aseteve, kontratave dhe burimeve njerëzore që lidhen me këtë aktivitet;
 - c) planifikimin dhe zhvillimin e investimeve në sektorin e prodhimit të ujit për konsum publik;
 - ç) ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, përpunimit dhe shitjes me shumicë të ujit për konsum publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Ushtrimi i aktivitetit sipas shkronjës “ç” të pikës 7 të kësaj pike realizohet vetëm pas përfundimit të periudhës tranzitore dhe përmbushjes së kushteve të përcaktuara në këtë vendim.
9. Për qëllime të organizimit dhe funksionalizimit të saj, OPU sh.a. ushtron veprimtarinë fillimisht në një periudhë tranzitore, e cila synon krijimin e bazës institucionale, teknike dhe financiare të nevojshme për operimin e plotë të shoqërisë.
10. Periudha tranzitore fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka kohëzgjatje deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në raste të arsyetuara, kjo periudhë mund të zgjatet me vendim të Këshillit të Ministrave, mbi bazën e një raporti të paraqitur nga ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe energjinë.
11. Gjatë periudhës tranzitore, OPU sh.a. nuk ushtron veprimtari operacionale në drejtim të prodhimit, përpunimit apo shitjes së ujit për konsum publik dhe nuk merr përsipër përgjegjësi për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese të prodhimit të ujit.
12. Veprimtaria e shoqërisë gjatë kësaj periudhe kufizohet në funksione përgatitore, organizative dhe koordinuese, të cilat synojnë krijimin e kushteve për marrjen në administrim të sistemeve të prodhimit të ujit dhe për fillimin e operimit të plotë të saj.
13. Periudha tranzitore konsiderohet e përfunduar vetëm pas verifikimit të përmbushjes së kushteve përkatëse dhe miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave të fillimit të operimit të plotë të shoqërisë.
14. Gjatë periudhës tranzitore, OPU sh.a. ushtron veprimtari të karakterit përgatitor dhe nuk ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në operimin e sistemeve ekzistuese të prodhimit për konsum publik, të cilat vijnë të administrohen nga operatorët përkatës.
15. Në funksion të përmbushjes së objektivave të saj, shoqëria ndërmerr dhe realizon veprimet e mëposhtme:

- a) përgatit, organizon dhe ndjek realizimin e procedurave për transferimin ligjor dhe kontabël të aseteve dhe kontratave;
 - b) koordinon dhe mbështet procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve, mbi bazën e të dhënave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga shoqëritë ekzistuese;
 - c) analizon gjendjen teknike, financiare dhe ligjore të aseteve dhe kontratave, me qëllim evidentimin e detyrimeve dhe përgatitjen e tyre për transferim;
 - ç) identifikon dhe planifikon nevojat për burime njerëzore, si dhe harton strukturën organizative dhe funksionale të shoqërisë;
 - d) harton dhe përditëson planin e biznesit 5 vjeçar, duke përfshirë parashikimet për zhvillimin e aktivitetit dhe qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, i cili miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja.
 - dh) përcakton dhe strukturon planin e investimeve, duke identifikuar prioritetet strategjike për zhvillimin e sistemeve të prodhimit të ujit; për konsum publik
 - e) përgatit dhe paraqet dokumentacionin për pajisjen me licencat dhe autorizimet përkatëse nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU);
 - ë) krijon dhe vendos në funksion sistemet bazë të menaxhimit financiar, të kontabilitetit, faturimit dhe administrimit të aseteve;
 - f) përgatit dhe zhvillon projekte, studime fizibiliteti dhe plane zhvillimi për infrastrukturën e prodhimit të ujit;
 - g) bashkëpunon me institucionet publike dhe operatorët ekzistues për realizimin e proceseve të nevojshme përgatitore;
 - gj) ndërmerret çdo veprim tjetër të nevojshëm për krijimin e kushteve për fillimin e operimit të plotë të shoqërisë.
16. Veprimet e kryera nga shoqëria gjatë kësaj periudhe nuk krijojnë të drejta apo detyrime që lidhen me operimin e drejtpërdrejtë të shërbimit të prodhimit të ujit.
17. OPU sh.a. nuk mban përgjegjësi për operimin, mirëmbajtjen apo administrimin e sistemeve të prodhimit të ujit gjatë periudhës tranzitore.
18. Gjatë periudhës tranzitore, shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve vijojnë të ushtrojnë përgjegjësinë e plotë për operimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve të prodhimit të ujit për konsum publik deri në përfundimin e transferimit të tyre tek OPU sh.a.
19. Në funksion të realizimit të këtij vendimi, shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve ngarkohen që:
- a) të kryejnë inventarizimin e plotë dhe të përditësuar të aseteve që lidhen me prodhimin e ujit për konsum publik, duke përfshirë evidentimin fizik, teknik dhe dokumentar të tyre;
 - b) të sigurojnë regjistrimin dhe pasqyrimin e saktë të aseteve në regjistrat përkatës, përfshirë regjistrat kadastralë dhe financiarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

- c) të administrojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për kontratat ekzistuese që lidhen me investimet, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të prodhimit të ujit;
 - ç) të vënë në dispozicion të OPU sh.a. të gjithë dokumentacionin teknik, financiar dhe ligjor që lidhet me asetet dhe kontratat, në mënyrë të plotë, të saktë dhe të verifikueshme;
 - d) të garantojnë vijimësinë e pandërprerë të shërbimit të prodhimit dhe furnizimit me ujë për konsum publik gjatë gjithë periudhës tranzitore;
 - dh) të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me OPU sh.a. dhe institucionet përgjegjëse për realizimin e proceseve të transferimit të aseteve dhe kontratave.
 - e) të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me OPU për transferimin e burimeve njerëzore.
Transferimi i burimeve njerëzore që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin e prodhimit të ujit realizohet sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërmjet palëve duke garantuar vijimësinë e kapaciteteve teknike dhe operative. OPU sh.a ka të drejtën të rekrutojë staf të ri në funksion të përmbushjes së objektivave të saj.
 - ë) të marrin masat e nevojshme organizative dhe administrative për të lehtësuar procesin e transferimit, në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse.
20. Deri në përfundimin e transferimit, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga pronësia, administrimi dhe përdorimi i aseteve, si dhe nga kontratat ekzistuese, mbeten pranë shoqërive rajonale të ujësjellës-kanalizimeve.
21. Transferimi i aseteve dhe kontratave që lidhen me prodhimin e ujit për konsum publik nga shoqëritë ekzistuese tek OPU sh.a. realizohet në mënyrë të planifikuar dhe graduale gjatë periudhës tranzitore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
22. Procesi i transferimit bazohet në parimin e vijimësisë së shërbimit dhe të ruajtjes së integritetit teknik dhe funksional të sistemeve të prodhimit të ujit.
23. Transferimi përfshin, në mënyrë të detajuar, asetet që lidhen me:
- a) nxjerrjen dhe kapjen e burimeve ujore;
 - b) trajtimin dhe përpunimin e ujit;
 - c) depozitimin dhe transmetimin e ujit drejt sistemeve të shpërndarjes;
 - ç) infrastrukturën ndihmëse dhe pajisjet mbështetëse të lidhura me këto funksione.
24. Transferimi i kontratave realizohet në përputhje me kushtet dhe detyrimet e parashikuara në to, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, duke garantuar vijimësinë e marrëdhënieve juridike dhe shmangien e ndërprerjeve në zbatimin e tyre.
25. Modalitetet, afatet dhe procedurat e detajuara për realizimin e transferimit përcaktohen me marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve dhe, sipas rastit, me akte të tjera nënligjore të miratuara nga autoritetet përgjegjëse.

26. OPU sh.a. merr në dorëzim asetet dhe kontratat vetëm pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore dhe administrative, si dhe pas verifikimit të plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit përkatës.
27. OPU sh.a. organizohet dhe funksionon në përputhje me modelin e shoqërisë aksionare me dy nivele administrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.
28. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve;
 - b) Këshilli Mbikëqyrës;
 - c) Administratori.
29. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ushtron të drejtat e aksionarit të vetëm dhe merr vendime për çështje themelore të organizimit dhe funksionimit të shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e saj.
30. Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr administrimin e shoqërisë dhe garanton përputhshmërinë e veprimtarisë së saj me objektivat strategjikë dhe kuadrin ligjor në fuqi.
31. Administratori është përgjegjës për drejtimin ekzekutiv të shoqërisë dhe për zbatimin e vendimeve të organeve drejtuese, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligj dhe në statut.
32. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të organeve drejtuese, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, përcaktohen në mënyrë të detajuar në statutin e shoqërisë, i cili miratohet sipas legjislacionit në fuqi.
33. Kapitali fillestar i OPU sh.a. është 200 milion (dyqind milion) lekë dhe përbëhet nga kontributi në para i aksionarit të vetëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili mund të rritet nëpërmjet transferimit të aseteve sipas legjislacionit.
34. Vlera e kapitalit fillestar transferohet nga buxheti i shtetit në llogaritë e shoqërisë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas procedurave përkatëse financiare dhe buxhetore.
35. Përveç kapitalit fillestar, OPU sh.a. financohet edhe nga burime të tjera të ligjshme, duke përfshirë:
- a) fondet buxhetore të destinuar për investime kapitale në sektorin e ujit;
 - b) grante, hua dhe instrumente të tjera financimi nga institucione financiare vendase dhe ndërkombëtare;
 - c) të ardhurat që krijohen nga ushtrimi i aktivitetit të saj, pas fillimit të operimit të plotë;
 - ç) burime të tjera financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

36. Administrimi dhe përdorimi i fondeve kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe me rregullat e brendshme të miratuara nga organet drejtuese të shoqërisë.
37. Fillimi i operimit të plotë të OPU sh.a. realizohet pas përfundimit të periudhës tranzitore dhe krijimit të kushteve të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
38. Për qëllime të kësaj pike, konsiderohet se janë krijuar kushtet për operim kur shoqëria është në gjendje të ushtrojë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme veprimtarinë e saj, duke përfshirë marrjen në administrim të aseteve përkatëse dhe pajisjen me licencat dhe autorizimet përkatëse nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU).
39. Vlerësimi i përmbushjes së kushteve për fillimin e operimit kryhet nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, e cila paraqet një raport përkatës në Këshillin e Ministrave.
40. Fillimi i operimit të plotë të shoqërisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
41. Nga momenti i miratimit sipas pikës 4 të kësaj pike, OPU sh.a. ushtron përgjegjësinë për administrimin, operimin dhe zhvillimin e sistemeve të prodhimit të ujit të pijshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
42. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndjekjen, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
43. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, merr masat e nevojshme për:
- a) themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë;
 - b) miratimin e statutit dhe ngritjen e organeve drejtuese të saj;
 - c) ndjekjen dhe monitorimin e procesit të periudhës tranzitore dhe të transferimit të aseteve dhe kontratave;
 - ç) sigurimin e përputhshmërisë së veprimeve të ndërmarra me legjislacionin në fuqi dhe objektivat e këtij vendimi.
44. Institucionet dhe subjektet e përfshira në zbatimin e këtij vendimi të bashkëpunojnë dhe të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me kompetencat përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA